



Datë: 26.01.2026
Numër Protokolli: 456/2026

A.nr.909/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1905/2022, të datës 29.05.2024, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.297/2019, të datës 27.05.2019, të parashtruar nga ankuesi I.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 26.01.2026 mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.297/2019 e datës 27.05.2019 e parashtruar nga ankuesi I.K.

A r s y e t i m

Ankuesi I.K, më datë 27.05.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të datës 10.05.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2452/2019 e datës 27.05.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Katalogun e Vendeve të Punë në Shërbimin Civil të Kosovës janar 2015; Vendimin A.nr.774/2018 të datës 21.12.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-amilin e datës 17.10.2018 të Rr.Z; Konkursin e Brendshëm të datës 30.10.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinimin e Politikave dhe Çështjeve Ligjore datës 05.02.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Arsim dhe Aftësim Profesional datës 05.02.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Arsim Parauniversitar i datës 05.02.2019;

Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit të arsimit të lartë, shkencës dhe teknologjisë i datës 05.02.2019; Akt Emërimi i datës 24.05.2013; E-maili i datës 15.05.2019 nga E.K për ankuesin; E-mailin e datës 13.05.2019 nga N.Sh-A për E.K; E-mailin e datës 10.05.2019 nga E.K për N.Sh-A dhe A.K; E-maili i datës 23.04.2019 nga E.K për B.D; E-mailin e datës 17.04.2019 dhe 05.02.2019, nga E.K për Rr.Z; E-mailin e datës 10.05.2019 nga E.K për ankuesin; Ankesën ndaj hapjes së konkursit të datës 02.11.2018 e parashtruar nga ankuesit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mailin e datës 29.06.2018 nga ankuesi për M.B; Organogrami i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Kërkesë për anulimin e Rregullores (QRK)-Nr.14/ 2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nga ankuesi e datës 12.10.2018 për Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës; Diplomën e datës 31.03.2003 të ankuesit; Librezën e Punës së ankuesit 20.05.1986; Certifikatat e ankuesit; Vendimin e datës 27.02.2015; Vërtetimin e marrëdhënies së punës i datës 14.06.2019 për ankuesin; Dosjen e F.D dhe Përgjigjen në ankesë e datës 25.06.2019; Njoftimin e datës 21.08.2019 për ankuesin dhe Aktgjykimin A.nr.2226/19 të datës 09.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, emalin e datës 01.07.2022 të A. K; Aktgjykimin A.nr.1905/2022 të datës 29.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.763/2024 të datës 22.09.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se:

- ankuesi sipas Akti të Emërimit të datës 24.05.2013, ka ushtruar pozitën Drejtor i Departamentit Ligjore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (me tej MASHT).
- Më hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK)-Nr.14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (*e miratuar në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës më datë 11.09.2018*), Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim e Politikave janë bashkuar në një departament me emërtimin Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinonin e Politikave dhe Çështjeve Ligjore, me ç'rast edhe pozita e ankuesit në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Ligjori është prekur nga ky riorganizim dhe si rrjedhojë sistemi i ankuesit i është nënshtruar procesit të riorganizimit.
- Organi i punësimit ende pa përfunduar procesin e sistemimit të stafit tepriçë nga riorganizimi sipas Rregullores (QRK)-Nr.14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 30.10.2018 ka shpallur konkursin për plotësimin e pozitave Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian, Koordinim të Politikave dhe Çështje Ligjore, kundër të cilit konkurs ankuesi kishte parashtruar ankesë më datë 02.11.2018, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (tutje vetëm KZKA) të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për anulimin e konkursit të kontestuar. KZKA-ja me Vendimin Nr.2-1K-2471 të datës 08.11.2018 është shpall jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, ndërsa, Këshilli me Vendimin A.nr.774/2018 të datës 21.12.2018, ka shfuqizuar Vendimin Nr. 2-1K-2471 të datës 08.11.2018 të KZKA-së, ka anuluar konkursin e kundërshtuar më ankesë si dhe ka detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të MASHT-it që të bëjë rishqyrtimin e rastit në pajtim me nenin 32 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 08/2012 për Nëpunësit Civilë Tepriçë, akte ligjore

të aplikueshme në atë kohë.

-Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më datë 10.05.2019 nëpërmjet e-mailit ka njoftuar ankuesin se: *në pamundësi që të ri caktohet në ndonjë pozitë ekuivalente ju propozojmë sistemimin në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit" në kuadër të Departamentit për Integrime Evropiane dhe Koordinimin e Politikave dhe Çështjeve Ligjore".*

-Ankuesi i pa kënaqur më propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të datës 10.05.2019, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nën shenjë A.nr.297/2019 të datës 27.05.2019, me pretendimet ankimore së Sekretari i Përgjithshëm ka vepruar në mënyrë të paligjshme pasi që i njëjti nuk ka zbatuar vendimin e Këshillit A.nr.774/2018 të datës 21.12.2018, dhe se ankuesi ka plotësuar të gjitha kriteret për pozitat e lira për katër departamente për të cilat janë shpallur konkurset e të cilat janë anuluar nga Këshilli me Vendimin A.nr.774/2018 të datës 21.12.2018.

-Bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.05.2019 Këshilli ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa, kjo e fundit më datë 25.06.2019 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

-Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa, më datë 21.08.2019 ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu, që ankuesi ka vazhduar me padi gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështja Administrative.

-Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 09.06.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2226/19, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit tani ankuesi duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 21.08.2019 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit të datës 27.05.2019.

-Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.2226/19 të datës 04.07.2022, ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit.

-Ankuesi kundër Vendimin A.nr.297/2022, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa, kjo e fundit më datë 29.05.2024 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1905/2022, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit duke anuluar vendimin e kontestuar dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

-Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kundër Aktgjykimit A.nr.1905/2022 të datës 29.05.2024, kurse, Gjykata e Apelit me Aktgjykim AA.nr.763/2024, të datës 22.09.2025 ka refuzuar ankesën duke e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me këtë çështja juridike-administrative, duke marr për bazë Aktgjykimin A.nr.1905/2022 të datës 29.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e palejuar, **SEPSE**:

Në kuptim të lejueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se në kohën e inicimit të procedurës ankimore ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, dhe se ri trajtimi i ankesës së datës 27.05.2019 behët në pajtim me këtë ligj. Rrjedhimisht, në këtë kontekst, Kolegji iu referua nenit 81 të Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil më të cilin është përcaktuar se: *1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2.Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.* Ndërsa, Rregullorja Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave më nenin 4 paragrafi 1 dhe nenin 11 ka parapare se: Neni 4: *1Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës*", Neni 11: *Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejt ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh.* Andaj, mbi këtë përcaktim ligjor rezulton fakti i pakontestueshme së nëpunësit civil në rast të pretendimeve për shkelje apo cenim të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punë me veprimin apo mos veprimin e organit publik si organ punëdhënës, fillimisht duhej të parashtronin ankesë pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që themelohej pranë çdo institucioni dhe me pastaj në ratës të pakënaqësisë më vendimin e KZKA-së kanë poseduar të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të KZKA-së. Pra, nisur nga ky konstatim ankuesi në rast të pakënaqësisë me sistemimin e tij të propozuar sipas emailit të datës 10.05.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm, fillimisht duhej të ushtronte ankesë të brendshme gjegjësisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e më pastaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo ankuesi, kishte parashtruar ankesa drejtpërdrejtë në Këshill.

Andaj, pas konstatimit si me lartë dhe duku u bazuar 16 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se *Para parashtrimi të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit,* dhe duke qenë së ankuesi më asnjë provë nuk dëshmon se ka shtruar paraprakisht ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të MASHT, fakt ky i konfirmuar edhe përmes emailit të datës 01.07.2022 të organit të punësimi përmes të cilit theksohet se " *... ju njoftojmë se në kohën kur kam qenë Kryesues i Komisionit të Ankesave, nuk kam pas në procedurë ankesë nga z. I.K*", kështu që, në mbështetje të nenit 129, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L- 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoj së ankesa me numër A.nr.297/2019 e datës 27.05.2019 është e papranueshme.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.909/2024

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, I.K;
- Luljeta Maxhuni, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit
- Arkivit të KPMSHCK- së.